



VËRTETIMI MBI DORËZIMIN E DOKUMENTIT

POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA

ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT

Duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pala e nënshkruar më poshtë vërteton pranimin e dokumentit:

Na osnovu Zakona br. 04/L-033 o Specijalnôj komori Vrhovnog suda Kosova za pitanja koja se odnose na Kosovsku agenciju za privatizaciju, dole potpisana stranka potvrđuje dostavu dokumenta navedenog dole:

Pursuant to Law no 04/L-033 on Special Chamber of the Supreme Court of Kosovo on Privatization Agency of Kosovo Related Matters, the below signed party acknowledges receipt of the document described below:

Numëri i lëndës: Broj predmeta: Case Number:

Data e regjistrimit: Datum registrovanja: Date registered:

C-V.-14-0007

01/08/2014

Paditës

Tužilac

Claimant

I paditur

Tuženi

Respondent

Përfaqësues

Punomočnik


Representative

Përfaqësues

Punomočnik

Representative

#	Titulli i Dokumentit:	Naziv dokumenta:	Document Name:	Datë Datum Dated
1	Aktivendim nga Dhoma	Rešenje komore	Decision of the Chamber	29/07/2014



Pala: Stranka: Party:

1. Agjencia Kosovare e Privatizimit

Authority • Privatization • Rruga Ilir Konushevc 8, Prishtinë

Pranuar nga: Primio: Received by:

Titulli: Zvanje: Title:

Data: Datum: Date:


Nënshkrimi Potpis: Signature:

01 AUG 2014

Në bazë të nenit 25.8 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033, të gjitha parashtrësit dhe dokumentet mbështetëse duhet të paraqiten ose në gjuhën shqipe ose në gjuhën serbe dhe të shoqërohen edhe me përkthimin në gjuhën angleze.

Na osnovu člana 25.8 Dodatka Zakona br. 04/L-033, svi podnesci i prateći dokumenti moraju da budu podneseni na albanskom ili srpskom jeziku zajedno s prevodom na engleski jezik.

Pursuant to Section 25.8 of the Annex of the Law no 04/L-033, all pleadings and supporting documents must be submitted either in Albanian or in Serbian accompanied by an English translation.



Përkshikimorën - za pisarnicu - for registry

<p style="text-align: center;">DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHITJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT</p>	<p style="text-align: center;">SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS</p>	<p style="text-align: center;">POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU</p>
---	---	---

C-V-14-0007

Parashtruesi i kërkesës

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), duke vepruar në cilësi të Administratorit të Ndërmarrjes Shoqërore “Trepça” nën administrim të AKP-së

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Specializuar i përbërë nga Sylejman Shumolli – Gjyqtar Kryesues, Vladimir Kanev – Gjyqtar i EULEX-it, dhe Cerim Fazliji – Gjyqtar, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 31 korrik 2014, lëshon këtë:

AKTVENDIM

1. Hedhet poshtë si e papranueshme kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e parashtruar në cilësi të Administratorit të “Ndërmarrjeve Trepça”, me të cilën kërkohet zgjatja e afatit për të mbajtur Mbledhjen e Parë të Kreditorëve.
2. Aprovohet kërkesa e AKP-së, e parashtruar në cilësi të njëjtë, me të cilën kërkohet zgjatja e afatit për dorëzimin e Planit të Riorganizimit për “Ndërmarrjet Trepça” deri më 2 prill 2015.
3. Udhëzohet AKP-ja që, jo më vonë se 30 ditë pas njoftimit lidhur me këtë aktvendim, të dorëzojë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës një raport të përmbledhur për planet e tyre të ardhshme lidhur me Riorganizimin.
4. Ky aktvendim duhet të publikohet në faqen e internetit të Agjencisë.
5. Njoftimi për zgjatjen e afatit të Planit të Riorganizimit duhet të botohet në gazeta siç parashihet me nenin 43 të Ligjit 04/L-035.
6. Obligohet Agjencia Kosovare e Privatizimit të paguajë 100 euro taksë gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 10 korrik 2014, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në cilësi të Administratorit të NSH-së "Trepça") parashtrroi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës një kërkesë në pajtim me Nenin 7.1 e në lidhje me nenin 42.1, 42.3, 42.4 dhe 42.5 të Ligjit për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre (Ligji për Riorganizimin) me të cilën kërkoi që Dhoma e Posaçme të lëshojë një Urdhër me të cilin aprovohet propozimi për zgjatjen e afatit për caktimin e Mbledhjes së Parë të Kreditorëve jo më vonë se 30 qershor 2015 si dhe të shtyhet parashtrimi i Planit të Propozuar të Riorganizimit deri më 31 dhjetor 2015. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu propozoi të obligohet Administratori që, brenda 15 ditëve nga data e pranimit të aktvendimit gjyqësor, ta publikojë njoftimin zyrtar për zgjatjen e afatit në fjalë siç është cekur në pikën 1 dhe 2 të propozimit; pastaj t'a obligojë administratorin që brenda 30 ditëve nga data e pranimit të aktvendimit gjyqësor t'u dërgojë letra të ndara informuese të gjithë kreditorëve të ditur të cilët kanë parashtruar padi kreditore, me të cilat i njofton ata për zgjatjen e afatit siç është cekur në pikën 1 dhe 2 të propozimit dhe gjithashtu t'a obligojë Administratorin që të publikojë aktvendimin e gjykatës në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Administratori konfirmon se dispozitat ligjore të lartcekura janë në pajtim me obligimet dhe detyrat e përgjithshme të parapara me Ligjin për Riorganizim dhe Ligjin mbi AKP-në.

Kërkesa/propozimi për zgjatjen e afatit për të caktuar Mbledhjen e Parë të Kreditorëve dhe zgjatjen e afatit për parashtrimin e Planit të Propozuar të Riorganizimit, sipas Administratorit, është e bazuar në interesat e përgjithshme të Ndërmarrjeve "Trepça" dhe në pajtim me mandatin e Administratorit për të ruajtur dhe rritur vlerën e Ndërmarrjes.

Përmes kësaj kërkesë, Administratori gjithashtu informoi gjykatën se Bordi i Drejtorëve i AKP-së nuk është i kompletuar me të gjithë anëtarët siç parashihet me Nenin 12 të Ligjit mbi AKP-në. Veç kësaj, parashtruesi i kërkesës ka tërhequr vëmendjen tek Neni 15.2.10 i Ligjit mbi AKP-në i cili parashih autoritetin ekskluziv të Bordit të Drejtorëve sa i përket miratimit të planeve të riorganizimit apo ristrukturimit të një Ndërmarrjeje.

Në ndërkohë, Administratori ngriti një situatë tjetër problematike, apo thënë më mirë, konfigurimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së pas skadimit të mandatit të anëtarëve ndërkombëtarë të Bordit më 31 gusht 2014 dhe emërimi i anëtarëve vendorë në Bordin e Drejtorëve të AKP-së. Në anën tjetër, AKP-ja gjithashtu i sugjeroi gjykatës që të ketë parasysh pasigurinë lidhur me emërimet e lartcekura nga Kuvendi i Kosovës, duke ditur që Kuvendi i Kosovës nuk është funksional që nga zgjedhjet parlamentare të qershorit. Për shkak të përbërjes jo të plotë të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, aftësia e Administratorit (Agjencisë) për t'i kryer detyrat e tij siç janë të definuara me Ligjin mbi AKP-në, është dukshëm e kufizuar.

Marrë në konsideratë të gjitha të lartcekurat, parashtruesi i kërkesës në këtë rast, ka ardhur në përfundim se një urdhër i lëshuar nga Dhoma e Posaçme, me të cilin aprovohet kërkesa e Administratorit për zgjatjen e afatit për caktimin e Mbledhjes së Parë të Kreditorëve dhe Plani i

Riorganizimit, është në interes të riorganizimit të Ndërmarrjes dhe në interes të vet Pronarëve dhe Kreditorëve të Ndërmarrjes për arsyet në vijim:

- Bordi i Drejtorëve i AKP-së do të themelohet dhe do të jetë operacional.
- Administratori do të jetë në pozitë për të mbrojtur interesat e Pronarëve dhe Kreditorëve si dhe të mbrojë dhe ta rritë vlerën e Ndërmarrjes.
- Administratori do të jetë në gjendje të plotësojë kërkesat siç janë të përcaktuara me Ligjin për Riorganizim, dhe
- Zgjatja e afatit në fjalë nuk do të vë ndonjë kufizim të veçantë ndaj autoritetit të Dhomës së Posaçme.

Bazuar në kërkesën e Administratorit, më 24 tetor 2013, Dhoma e Posaçme ka lëshuar udhëzime në lëndën nr. C-V-13-0011 lidhur me zgjedhjen e ofruesit të shërbimeve profesionale.

Me aktvendimin C-V-13-0012, Dhoma e Posaçme ka miratuar kërkesën e Administratorit për zgjatjen e afatit për 30 ditë të tjera për caktimin e Mbledhjes së Parë të Kreditorëve.

Duhet cekur që Dhoma e Posaçme është në dijeni për dështimin Administratorit në procesin e zgjedhjes së ofruesit të shërbimeve profesionale për NSH-në "Trepça". Dhoma e Posaçme është gjithashtu në dijeni për iniciativën e ligjvënësit (Kuvendi i Republikës së Kosovës) për të ndryshuar Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe për të vënë "Trepçën" si Ndërmarrje Publike nën këtë ligj.

Arsyetimi ligjor:

Esenca e kërkesave:

Në cilësi të administratorit të "Ndërmarrjeve Trepça", Agjencia Kosovare e Privatizimit ka kërkuar nga gjykata zgjatjen e dy afateve të caktuara sipas ligjit.

-/ Afati për mbajtjen e Mbledhjes së Parë të Kreditorëve (Neni 19.1 i Ligjit 04/L-035), ka skaduar në maj 2014.

-/ Afati për dorëzimin e Planit të Riorganizimit (Neni 22.1 i ligjit 04/L-035), do të skadojë në fund të korrikut 2014.

Vlerësim i përgjithshëm ligjor:

Në bazë të ligjit 04/L-035, Dhoma e Posaçme është mbikëqyrësi më i lartë i procedurës së riorganizimit dhe në këtë cilësi ka kompetencë për të zgatur afatet, pasi të ketë shqyrtuar interesin e subjektit që është në riorganizim dhe të kreditorëve të tij. Megjithatë, kjo kompetencë është e kufizuar me dispozitën ligjore nga neni 42.4 e po të njëjtit ligj. Kjo dispozitë përcakton se të gjitha afatet mund të vazhdojnë përveç atyre për të cilat një dispozitë e veçantë kufizon kompetencën e gjykatës për ta zgatur afatin. Andaj, kërkesat në fjalë do të shqyrtohen sipas radhës në vijim:

1. A është zgjatja e kërkuar e afatit ligjërishit e mundshme – do të thotë, kompetenca e gjykatës për të zgatur afatin nuk pengohet nga ndonjë kufizim i veçantë ;
2. A është zgjatja e mundshme e afatit në interes të subjektit dhe të kreditorëve të tij;
3. Po qe se përgjigja në dy pyetjet e para është pozitive, atëherë duhet të vendoset lidhur me afatet kohore dhe kushtet e ardhshme.

Kërkesa për zgjatjen e afatit për Mbledhjen e Parë të Kreditorëve:

Në bazë të nenit 19 të Ligjit për Riorganizimin (Ligji 04/L-035), AKP-ja duhet të caktojë një datë për të thirr këtë mbledhje jo më vonë se 90 ditë pas afatit për parashtrimin e kërkesave. Njoftimi për afatin për parashtrimin e kërkesave ishte shpallur më 1 nëntor 2013 dhe ka mbaruar më 2 janar 2014. Mbledhja është dashur të mbahej në fillim të prillit 2014.

Më 12 dhjetor 2013, AKP-ja parashtrroi kërkesë për zgjatje prej 30 ditëve të këtij afati në pajtim me mundësinë e ofruar nga neni 19.1 i Ligjit. Me aktvendim në lëndën C-V-13-0012, Gjykata aprovoi këtë kërkesë mbi bazën që AKP-ja do duhej të angazhonte Ofruesin e Shërbimeve Profesionale për procedurën e riorganizimit.

Tani gjykata po trajton kërkesën e dytë për zgjatje të tillë të afatit, kësaj radhe deri më 30 qershor 2015.

Formulimi i saktë i nenit 19.1 është: *“Gjykata mund të zgjasë periudhën kohore për mbajtjen e mbledhjes së parë të kreditorëve për tridhjetë (30) ditë shtesë.”*

Këtë formulim gjykata e kupton ashtu që zgjatja prej 30 ditëve mund të miratohet vetëm një herë. Interpretimi i tillë është logjik duke pasur parasysh që afati në fjalë llogaritet duke i shtuar ditët kalendarike datës së afatit për parashtrimin e kërkesave (“pas 90 ditëve) meqë ky lloj shtimi i mundshëm përcaktohet në dispozitë ligjore, asnjë zgjatje tjetër e afatit nuk mund të lejohet.

Andaj, zgjatja e afatit për Mbledhjen e Parë të Kreditorëve nuk është e mundur dhe kërkesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme. Natyrisht, kjo nuk do të thotë që AKP-ja mund ta

anashkalojë këtë mbledhje. Agjencia do të bëjë ç'është e mundur që ta mbajë atë sa më shpejt që është e mundur.

Kërkesa për zgjatjen e afatit për Planin e Riorganizimit

Sipas nenit 22 të Ligjit për Riorganizimin, AKP-ja duhet të përgatisë dhe dorëzojë pranë Dhomës së Posaçme Planin e Riorganizimit brenda 9 muajve pas afatit për parashtrimin e kërkesave – do të thotë fundi i korrikut 2014. Dispozita e njëjtë ligjore lejon Dhomën e Posaçme që ta zgjatë këtë periudhë kohore prej 6 muaj deri në gjithsej 15 muaj. Prandaj, zgjatja e afatit është ligjërish e mundshme dhe gjykata do të shqyrtojë nëse kërkesa është e bazuar dhe si do të ndikojë ajo në interesat e Subjektit dhe kreditorëve.

Është shumë e qartë se Agjencia e Privatizimit është krejtësisht e papërgatitur që madje të fillojë me hartimin e Planit. Në parashtrësën e saj, Agjencia paraqiti sqarimet dhe arsyet përse ata nuk janë të gatshëm. Këto arsye mund të ndahen në grupe si në vijim:

1. Mungesë e aftësisë administrative sepse organet menaxhuese të AKP-së janë jo komplete.
2. Mungesë e aftësisë profesionale – AKP-ja ka nevojë për Ofrues të Shërbimeve Profesionale për të vlerësuar kërkesat dhe për ta hartuar Planin e Riorganizimit për t'i rigjallëruar Ndërmarrjet si subjekte rentabile ekonomike.
3. Mungesë e bashkërendimit me dhe ndërhyrja nga institucionet tjera.
4. Pasiguria sa i përket legjislacionit dhe kompetencave në të ardhmen mbi Ndërmarrjet Trepça.

Gjykata do t'i shqyrtojë të gjitha këto fakte dhe ndikimin e tyre tek Ndërmarrjet dhe kreditorët. Të gjitha faktet e pohuara janë zyrtarisht të njohura për gjykatën nga procedurat e kaluara (shih aktvendimet në lëndët: C-V-13-0011; C-V-13-0012; C-V-14-0004). Dhe, disa nga faktet – si përbërja jo e plotë e Bordit të Drejtorëve të AKP-së janë botërisht të njohura. Gjykata është gjithashtu e vetëdijshme se afati për riorganizimin e “Ndërmarrjeve Trepça” tashmë ka kaluar. Fillimisht, njoftimi për afatin e parashtrimit të kërkesave është dashur të shpallej më 1 nëntor 2012. Në bazë të miratimit të Gjykatës, kjo ishte shtyrë deri më 1 nëntor 2013. Nga data 2 janar 2014, Agjencia është dashur të fillonte vlerësimin e kërkesave të regjistruara dhe përgatitjen e Mbledhjes së Parë të Kreditorëve. Për këtë qëllim, Agjencia ka nevojë për Ofruesin e Shërbimeve Profesionale. Por, AKP-ja kishte filluar tek në tetor 2013 procedurën e tenderimit për të angazhuar një Ofrues të tillë. Procedura e tenderimit zgjati për disa muaj dhe përfundimisht u anulua në maj 2014. Sipas parashtrësive, vetëm një nga nëntë ofertues në procedurën e tenderit paraqitën “ofertë të përgjegjshme”, kështu që procedura duhej të anulohet. AKP-ja nuk ka saktësuar se çka nënkupton “ofertë të përgjegjshme”.

Pavarësisht nga të gjitha pengesat tjera, mungesa e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale mjafton për të parandaluar zhvillimin e mëtejshëm të procedurës së riorganizimit.

Në anën tjetër, gjykata konstaton se tashmë është e dëshmuar se disa organe qeveritare kanë provuar ta pezullojnë procedurën e riorganizimit. Arsyeja kryesore për ndërhyrje nga jashtë ishte projekt ligji i cili kinse do t'i kalonte disa kompetenca mbi "Ndërmarrjet Trepça" nga AKP-ja tek Qeveria. Me këtë rast, Dhoma e Posaçme nxori aktvendimin C-V-13-0011 me të cilin ishte udhëzuar Agjencia që ajo mbanë kompetencë dhe përgjegjësi ekskluzive për procesin e riorganizimit dhe se duhet të marrë parasysh vetëm ligjin dhe udhëzimet e gjykatës. AKP-ja është udhëzuar gjithashtu se projekt ligjet nuk janë arsye për të pezulluar veprimet e riorganizimit.

Për fund, gjykata duhet të shqyrtojë problemet ekzistuese në organet menaxhuese të AKP-së. Është e ditur se 3 nga 8 anëtarë të Bordit të Drejtorëve kanë dhënë dorëheqje shumë kohë më parë dhe vendet e zbrazëta akoma nuk janë plotësuar. Që nga prilli 2013, Bordi vepron me vetëm 5 Drejtorë. Veç kësaj, më 31 gusht 2014, i skadon mandati dy anëtarëve ndërkombëtar të Bordit dhe, përveç nëse Kuvendi i Kosovës emëron zëvendësimet e tyre, Bordi do të bëhet plotësisht jofunksional. Duke pasur parasysh procesin në pritje të themelimit të Kuvendit dhe Qeverisë, ka shumë gjasa që zëvendësimet nuk do të emërohen për muaj të tërë. Për më tepër, që nga shkurti 2014, Agjencia nuk ka një titullar Drejtor Menaxhues. Këto rrethana kanë ndikuar, apo do të ndikojnë, negativisht në aftësinë administrative të Agjencisë. Për këtë arsye gjykata vendosë për të zgatur afatin për Planin e Riorganizimit në afatin maksimal të pranueshëm – 2 shkurt 2015, me të cilin arrihet në gjithsej 15 muaj. Kjo është zgjatja maksimale që mund të aprovohet në bazë të ligjit të aplikueshëm – Ligji 04/L-035.

Zgjatja e afatit e aprovuar do të shfrytëzohet nga Agjencia për ta kryer procedurën në këto rrethana dhe Dhoma e Posaçme do të vazhdojë me mbikëqyrje të afërt. Për të arritur këtë, Agjencia do të parashtojë një raport përmbledhës, lidhur me planet e tyre për riorganizim, jo më vonë se 30 ditë pasi ta kenë pranuar këtë aktvendim.

Ky aktvendim duhet të publikohet në faqen e internetit të Agjencisë. Njoftimi për zgjatjen e afatit për Planin e Riorganizimit, duhet të botohet në gazeta, siç parashihet me nenin 43 të Ligjit 04/L-035.

Taksat gjyqësore:

Në pajtim me vendimin e KGJK-së mbi taksat gjyqësore në Dhomën e Posaçme, të publikuar më 27 mars të këtij viti dhe vendimin e Presidiumit të Dhomës së Posaçme, të datës 8 prill të këtij viti, parashtruesi i kërkesës do të paguajë €100 euro taksë për procedurën gjyqësore.

Këshillë juridike

Në bazë të Nenit 10.6 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, brenda njëzet e një (21) ditëve nga data e pranimit të këtij aktvendimi.

Sylejman Shumolli, Gjyqtar Kryesues,

